



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 17 prot.

Kamëz, më 17 02 2021

V E N D I M

Nr. 14 Datë 19.02.2021

PËR

MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN

**“Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”**

**për vitin 2021**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **19.02.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.14 Datë 15.02.2021**, drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit, mbështetur në pikën 2, te nenit 24, germa "k" e nenit 54, te Ligjit Nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", referuar Ligjit Nr. 22/2018 " Për Strehimin Social", VKM nr. 384, datë 12.6.2019 " Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore ", VKM nr. 454, datë 3.7.2019, "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", VKM nr. 458, datë 3.7.2019, VKM nr. 823, datë 18.12.2019 ,Udhëzimit të Minsitrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 31, datë 18.11.2019 "Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit" ,shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.prot.657 datë 14.01.2021 " Për projektet e strehimit" **Këshilli Bashkiak Kamëz :**

V E N D O S I :

1. Të miratojë sistemin e pikëzimit për trajtimin sipas programit " **Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara**".  
Miratimin e mënyrës së vlerësimit dhe llogaritjes sipas Aneksit nr.1 dhe 2.
2. Miratimin e listës së dokumentacionit që duhet të dorëzojnë aplikantët .

3. Bashkëngjitur këtij Vendimi aneksi 1, aneksin 2 si dhe listën e dokumentacionit që duhet të dorëzojnë familjet aplikuese.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

**Nën/Kryetar Këshilli**

